

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Refki Piraj, me procesmbajtësen Halime Nixha, sekretare juridike e kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarve A. C. nga Prizreni, dhe S. C. nga Prizreni, të akuzuar sipas aktakuzës së PTH në Prizren PP/II.nr.2682/14 e dt. 24.08.2016, për shkak të veprës penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 188/3-1, nen par.1.1 të KP-së,dhe veprës penale sulmi nga neni 187 par.1-31 teKP-së., në prezencën e të akuzuarve, prokurorit të shtetit Zenulla Gashi , më dt.23.10.2017, muar dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit :

A. C. i lindur me *data e lindjes...* ne Prizren me banim ne rr..., nga i ati A. e ema B., ka te kryer shkollën fillor, i martuar babe i 1 femiu, mekanik , i gjendjes se dobet ekonomike, turk shtetas i R. te Kosovës.

S. C. i lindur me *data e lindjes...* ne Prizren me banim ne rr.... nr..., nga i ati A. e ema B., ka te kryer shkollën e mesme i pa martuar , puentore , i gjendjes se dobet ekonomike, turk shtetas i R. te Kosovës.

JANË FAJTOR

I pandehuri A. C.

I. Se me dt. 29.06.2014 rreth ore 20:40 min, ne Prizren ne rr. ... i shkakton lëndime te lehta trupore personit tjetër i cili rezulton me dëmtimin e përkohshëm te shëndetit te personit tjetër, ne atë mënyrë qe per shkak te nje mosmarrëveshje te mëparshme ne mes te pandehurit dhe te dëmtuarit A. E., i pandehuri papritur del ne rruge dhe e sulmon fizikisht te dëmtuarin A. P., duke e goditur me nje thike ne pjesën e pasme te shpinës me q rast i shkakto lëndime te lehta trupore dhe ate: plage – prerëse-shpuese ne regjionin iJOR, lëndime te përshkuara ne per se afërmi ne mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjeko ligjor. Te dt. 11.12.2014

Këso dore ka kryer veprën penale lëndim i lehte trupor nga neni 188 par.2 lidhru me par.1 nen par.1.4 te KP-së.

II.Te pandehurit A. C. dhe S. C.

II.me date kohe dhe vend te njëjtë te përshkuar si ne diapozitivin e pare te kësaj akuze ne bashkëveprim me dashje përdorin forcën ndaj personit tjetër, ne ate mënyrë qe për shkak te nje mosmarrëveshje te mëparshme ne mes te panehurve dhe te dëmtuarit A. E., te pandehurit papritur i dalin ne rruge dhe e sulmojnë fizikisht te dëmtuarin duke e goditur me grushte ne pjesë te ndryshme te trupit.

Këso dore ne bashkëkryerje kane krye veprën penale te sulmit nga neni 187 par.1 -31 teKP-së.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 41,43,64, 49, 50, 51 dhe 52 te KP t e akuzuarve iu shqipton :

Te akuzuarit A. C. per veprën penale nen I te aktakuzës

DËNIM ME KUSHT

Me burg ne kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj cili dënim nuk do te ekzekutohet ne afatin prej 1 (nje) viti, nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i pandehuri nuk kryen vepër te re penale.

Dhe per veprën penale nen II te aktkauzues;

DENIM ME GJOBE

Ne shume prej 160 (njëqindegjashtëdhjetë) euro te cilin dënim do ta paguaj ne xhirollogarinë e kësaj gjykata nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, e poqe se dënimi me te holla nuk mund te paguhet nga ana e te akuzuarit ne afatin ligjore i njëjti do te zëvendësohet me dënim me burg duke llogaritur 20 euro per 1 dite burg gjegjësisht 8 dite burg.

Te akuzuarit S. C. per veprne penale nen II te aktakuzës i shqipton

DENIM ME GJOBE

Ne shume prej 160 (njëqindegjashtëdhjetë) euro te cilin dënim do ta paguaj ne xhirollogarinë e kësaj gjykata nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, e poqe se dënimi me te holla nuk mund te paguhet nga ana e te akuzuarit ne afatin ligjore i njëjti do te zëvendësohet me dënim me burg duke llogaritur 20 euro per 1 dite burg gjegjësisht 8 dite burg.

Te dëmtuarit A. P. nga Prizreni L. D. pn, dhe A. E. nga Prizreni rr.... pn, per realizimin e kërkesë pasurore juridike udhëzohet ne kontest te rregullt civil.

Obligohen te pandehurit qe ti paguajn shpenzimet e procedurës sado qe te behen ato sipas llogaritjes nga ana e gjykatës , ne emër te paushallit gjyqësor secili nga 20 euro, ,kurse i akuzuari A. C. per ekspertizën mjeko ligjore shumën prej 20 euro , te gjitha keto ne afat prej 15 ditesh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nen kercnim te ekzekutimit te dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Prizren , i ka paraqitur kësaj gjykate aktakuzën PP/II.nr.2682/14 e dt. 24.08.2016, kundër te pandehurve A. C. nga Prizreni, dhe S. C. nga P., për shkak të veprës penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 188/3-1, nen par.1.1 të KP-së,dhe veprës penale sulmi nga neni 187 par.1-31 teKP-së

Te pandehurit A. C. dhe S. C. ne shqyrtimin fillestar , në tërsi kan pranuar veprën penale e cila iu vihet në barrë sipas aktakuzës .

Gjyqtari gjykues përcakton se te pandehurit e kane kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajit, pranimi është i vullnetshëm dhe mbështetet ne faktet e çështjes qe përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike, andaj me aktvendim pranon pranimin e fajësisë.

Kjo gjykatë gjeti se në veprimet e të akuzuarit A. C. , plotësohen të gjitha elementet qenësore te veprës penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 188/3-1, nen par.1.1 të KP-së,dhe veprës penale sulmi nga neni 187 par.1-31 te KP-së, andaj i shqiptoi dënimin burg me kusht dhe dënimin me gjobe, kurse ne veprimet e te akuzuarit S. C. plotësohen te gjitha elementet qenësore te veprës penale sulmi nga neni 187 par.1-31 te KP , prandaj dhe ia shqiptoi dënimin me gjobe, duke qenë i bindur se me këtë lloj dënimi do te arrihet qëllimi i të njëjtit.

Me rastin e vërtetimit te dënimit per veprën penale, gjykata vlerësoi te gjitha rrethanat te cilat në kuptim te nenit 73 te KP-së ndikojnë ne përcaktimin e lartësisë se dënimit.

Gjykata çmoi rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese secilën ne veçanti dhe lidhshmërinë ne mes te tyre me te gjitha rrethanat tjera te cilat ishin me ndikim ne përcaktimin dhe qëllimin e dënimit.

Si rrethana ne përcaktimin dhe lartësinë e dënimit gjykata kishte parasysh intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit te vlerës se mbrojtur, kurse ne rrethanat lehtësuese pranimin e fajit pendimin per veprën dhe rrethanat familjare. Ne caktimin e dënimit me gjobe gjykata pati per baze gjendjen ekonomiko sociale te te akuzuarve.

Vendimi mbi udhëzimin ne kontest civil u mur ne kuptim te nenit 463 par.2 te KP.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është mare ne kuptim te nenit 450 dhe 452 të te KPP-se.

Më sa u tha më lartë u vendos si ne shqiptim të ketij aktgjykimi .

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1781/16 te dt.23.10.2017

Procesmbjatesja:
Halime Nixha

Gjyqtari:
Refki Piraj

DHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, mund të ushtrohet ankes, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit ne Prishtine , e nëpërmjet të kesaj gjykate.